

Dr. Hamit Duran*

NGA PO SHKON ZVICRA? **

(Disa reflektime lidhur me votimet e 26 shtatorit 2004)

Më 26 shtator 2004 në Zvicër u votua për propozimet për lehtësimin e marrjes së shtetësisë nga ana e gjeneratës së dytë dhe të tretë të të huajve. Siç edhe u prit, këto propozime nga shumica e votuesve u hodhën poshtë. Përveç polemikës dhe përhapjes së frikës nga disa qarqe politike djathtiste, për këtë rezultat negativ ka kontribuar edhe pasiviteti i vetë muslimanëve.

“Muslime bald in der Merheit?” (“Muslimanët së shpejti shumicë”), ishte kjo parulla që me shkronja të mëdha në prag të zgjedhjeve të 26 shtatorit 2004 gati sa nuk ua shpoi sytë shumë lexuesve të gazetave. Sa për rikujtim: këtu bëhej fjalë, për veç të tjerash, për lehtësimin e marrjes së shtetësisë për gjeneratën e dytë dhe (gati) marrje automatike të shtetësisë për gjeneratën e tretë të të huajve që jetojnë në Zvicër. SVP-ja (Schweizerische Volkspartei - Partia Popullore e Zvicrës) startoi një kampanjë të gjerë me pllakata dhe njoftime, me ç’rast njoftimi i parë me titullin e lartpërmendur u botua në shumë gazeta ditore. Aty u mashtruan lexuesit me lajmin se në bazë të regjistrimit të popullsisë të bërë në vitet 1990 dhe 2000, numri i muslimanëve për çdo 10 vjet është dyfishuar dhe se pritet që në bazë të kësaj në vitin 2040 numri i tyre të arrijë shkallën prej 72 % të popullsisë së përgjithshme të Zvicrës. Së paku disa gazeta, në të njëjtin numër, krahas këtij lajmi, e shprehën qëndrimin e tyre lidhur me këtë duke u distancuar nga kjo politikë. Një lajm tjetër me një titull akoma më provokues **“Prägen bald Muslime unsere Frauenpolitik?”** (“A do ta përcaktojnë së shpejti muslimanët politikën e gruas te ne?”), u lansua pak ditë para fundjavës së votimeve. Në bazë të një artikulli në *Der Bund* të datës 23. 09. 2004 i cili më nuk u prezantua në asnjë gazetë dhe të gjitha ato, përveç gazetës gratis *20 Minuten*, e hodhën poshtë si shumë ekstrem, sepse këtu të gjithë muslimanët në mënyrë të përgjithësuar u barazuan me terroristët. Siç e dimë ne të gjithë, të dyja propozimet u hodhën poshtë bindshëm dhe sërish hendeku u zgjerua edhe më tej. Përballë një refuzimi të qartë në Zvicrën gjermanofone dhe në Tessinë, në Zvicrën perëndimore qëndron një miratim i lehtë. Unë them ‘kjo është e pritur’, sepse si një i lindur dhe i rritur këtu, i njoh shumë mirë zviceranët. Gjithçka tjetër, pos refuzimit, do të më kishte befasuar. Ndër të tjera, unë qysh para disa vitesh kam edhe një “pasaportë të kuqe”.

Tani unë dëshiroj t’i trajtoj një çik pasojat për ne muslimanët nga këndvështrimi im personal. Mendoj se në rend të parë qëndrojnë këto dy aspektet vijuese:

1. Në ndërkohë ne këtu në Zvicër kemi arritur që me rrena të kulluara e pa kurrfarë pengese të mund të zhvillojmë propaganda të ndryshme dhe të njëjtat të merren për serioze nga ana e qytetarëve zviceranë.

* Doktor në fushën e elektroteknikës dhe botues i revistës *Die Barmherzigkeit* (www.barmherzigkeit.ch).


** Kjo është një kumtesë që autori e ka mbajtur më 30 tetor 2004 në tribunën me titull *Integrimi i muslimanëve në shoqërinë zvicerane* të organizuar nga Bashkësia Islame Shqiptare „Hëna e re“ në Kreuzlingen, Zvicër.

2. Fokusi i SVP-së (Partisë Popullore të Zvicrës) dhe i partive të tjera me orientim djathtist, të cilat në bazë të të dhënave të tyre në mënyrë precize dhe të denjë e përfaqësojnë mendimin e popullit, nuk drejtohet kah të huajt në përgjithësi, por pa mëdyshje në mënyrë të drejtpërdrejtë drejt neve muslimanëve.

Në fillim disa mendime lidhur me pikën e parë. Sikur që ceka më lart, SVP-ja me pretendimin se në vitin 2040 me një pjesëmarrje prej 72 % muslimanët do të përbëjnë shumicën e popullsisë zvicerane, tentoi që te popullata vendase të mbjellë frikë ndaj Islamit. Për fat të keq, kjo edhe u shkoi për dore, për çka tregojnë qartë edhe rezultatet e votimeve. Përse bëhet fjalë këtu, për një rrenë apo për një ngatërrim? Më 18 shtator 2004, Enti Federal për Statistikë publikoi një qëndrim (www.bfs.admin.ch) në të cilin thuhet: „Shifrat e llogaritura për vitet 2010-2040 nuk burojnë nga BFS (Bundesamt für Statistik – Enti Federal për Statistikë). Këto llogaritje nuk kanë mbështetje demografike dhe metoda e zbatuar – dyfishimi i numrit të muslimanëve për çdo 10 vjet – nuk ka kurrfarë baze shkencore. Po të shqyrtohet metoda e tyre do të del në shesh përse autorët këto llogaritje i ndërpresin me vitin 2040. Sipas kësaj logjike, në vitin 2050 numri i muslimanëve do të rritet për 144 % “.

Në *FACTS* nr. 39 të datës 23.09.2004 (www.facts.ch/dyn/magazin/frame/archiv/archivpdf/index.php) botohet një artikull më i gjatë lidhur me këtë temë i titulluar “Rassisten bald in der Mehrheit?” (‘Racistët së shpejti në shumicë?’). Aty ndër të tjera mund të lexojë: “Duart e zeza po zgjaten drejt pasaportave të kuq dhe së shpejti muslimanët mund të përbëjnë popullatën shumicë: me pamje e pretendime të këtilla polemizojnë qarqe të afërta me SVP-në kundër propozimligjeve për lehtësimin e procedurës së marrjes së nënshtetësisë. Nëse një lëkurëzi më lehtë e merr pasaportën e Zvicrës, druajmë nga një fatkeqësi. Nëse qytetari (zviceran) nuk ia vë mendjen, së shpejti do të mbivotohet nga islamistët. Kjo është e gabuar. Propagandat e ashpra nuk u pëlqejnë as edhe vetë qytetarëve të thjeshtë. Pas këtij diskutimi serioz, kjo shihet si një retorikë e zakonshme e paravotimit”. Ngjashëm me këtë tingëllonin edhe disa publikime të tjera.

Përkundër krejt kësaj, unë do të doja si një inxhinier ta trajtoj çështjen në mënyrë shkencore. Ashtu si edhe SVP, edhe unë i mora në dorë të dhënat e regjistrimit të popullsisë të bërë në vitin 1990 dhe 2000. Sipas tyre, numri i popullsisë muslimanë gjatë kësaj hapësire kohore është rritur nga 2.2 % në 4.5 %. Në të njëjtën kohë numri i popullsisë jomuslimane është zvogëluar për 1.33 %. Unë e mora që numri (e jo përqindja, që është një budallaki) i muslimanëve për çdo 10 vjet dyfishohet, kurse numri i jomuslimanëve zvogëlohet për 1.33 %. Ajo çka rezultoi nga kjo është e paraqitur në grafikun më poshtë.



Edhe nga kjo “mbillogaritje” vërehet se numri i muslimanëve, dikur, përafërsisht në vitin 2045, do të arrijë në 50 %. Shumë më interesant do të ishte numri i përgjithshëm i popullatës së Zvicrës së asaj kohe: ajo do të numëronte 13 milionë banorë. Në vitin 2060 do të kishte 26 milionë, kurse në vitin 2070 madje 47 milionë etj.! Më falni: asnjë njeri i ndërgjegjshëm nuk do t'i besojë këtij zhvillimi kaq rapid. Dhe çka thotë gjoja përfaqësuesi i mendimit të popullit zviceran, deputeti (njëkohësisht edhe ministri) i SVP-së Christoph Blocher lidhur me kampanjën “e dëshmuar shkencërisht-statistikisht” të partisë së tij? Do ta citojmë nga gazeta NZZ (*Neue Zürcher Zeitung*) të datës 5 tetor 2004: “Nuk është detyrë e qeverisë që në fushatën parazgjedhore ta korrigjojë çdo informacion të gabuar, thoshte kryetari i Zvicrës (Couchepin) lidhur me shpalljet për ‘muslimanët’. Qytetarët kanë mjaft argumente për t'i korrigjuar këto të dhëna të gabuara. Të njëjtin qëndrim e prezenton edhe ministri Blocher në një pyetje të parashtruar nga Jean-Michel Cina (cyp., Wallis). Transmetimet mos qofshin të vërteta ose të rreme, “ndoshta janë absurde”. Informatat vërtet të gabuara ai do t'i hidhte poshtë.”

Unë do të doja të dija se për cilët qytetarë flasin këtu Couchepin dhe Blocher. Mos ndoshta për ata të cilët nuk ishin në gjendje që të dhënat e gabuara t'i vendosnin në vendin e vet dhe që dy herë votuan me “Jo”? Apo mos ndoshta shumica e zviceranëve nuk janë të aftë t'i korrigjojnë informacionet e gabuara?

Tani dëshiroj t'i them disa fjalë lidhur edhe me pikën e dytë. Sikur që u cek më lart, SVP-ja nuk i merr në shënjestër të gjithë të huajt, por drejtpërdrejt muslimanët. Këtu hyjnë natyrisht edhe muslimanët me origjinë zvicerane. Një herë duhet ta kemi parasysh këtë, se SVP-ja i shpall qytetarët e vet për terroristë, vetëm pse janë muslimanë! A thua nuk duhet që këta vëllezër e motra ta marrin fjalën dhe zëshëm t'i kundërvihen kësaj?

Lexuesve të rregullt të gazetës sonë (*Die Barmherzigkeit*) ndoshta do t'u kujtohet se në nr. 56, në artikullin “Po rritet presioni mbi ne muslimanët”, pata shkruar se duket që po përgatitet një shfarosje sistematike kundër ne muslimanëve. Tani, kampanja e shpalljeve i përshtatet tamam kësaj fotografie. Tanimë “të këqinj” nuk janë të gjithë të huajt, por qartazi *muslimanët!* Atëherë pata shkruar në lidhje me ndalimin e shamisë nëpër shkollat e Francës, se në bazë të formulimit është vetëm çështje kohe se kurë kjo ndalesë do të vlejë vetëm për muslimanët, e jo edhe për të tjerët, para së gjithash për bashkësitë krishtere dhe çifute. Dhe çka ndodhi në ndërkohë? Sipas *Spiegel online* (www.spiegel.de) të datës 7 tetor 2004, i pari Land (Republikë) gjerman, i cili udhëhiqet me shumicë nga CDU-ja “krishtere”, që e ndalon bartjen e shamisë për të gjitha të punësuarat në shërbimet publike d.m.th. për mësueset, nëpunëset etj. ishte Landi Hessen. Simbolet krishtere me këtë rast mbetën të lejuara haptazi. Kjo është edhe një e dhënë se çdo të ndodhte sikur SVP-ja të ishte përcaktuesja e vetme e politikës së vendit. Për fat të mirë, CVP (Christliche Volks Partei – Partia Krishtere Popullore) lidhur me këtë çështje qëndron e distancuar dhe e zhveshur në kuptimin pozitiv nga politika e partive të tjera. Sikundër e keni të njohur përgjithësisht, një motër me shami e quajtur Kadriye Koca-Kasan është kandiduar nga CVP-ja e Baselit për një ulëse në Kuvendin e Baselit. Në *Basler Zeitung* të datës 23 korrik 2004 mund të lexoje: “E këtij mendimi është edhe nënkryetarja e CVP-së Therese Ruch, e cila është e gatshme që të rrezikojë: ‘Ne jemi të vetëdijshëm se ndoshta do të humbasim votues nga radhët tona’. Përkundër kësaj, kandidatura e Kadriye Koca-Kasanit është “një çast i gëzueshëm”. “Përmes kësaj hapjeje ne dëshirojmë të fitojmë votues e votuese të reja”. Votimet u zhvilluan më 24 tetor 2004. Me 1239 vota pro, Kadriye Koca-Kasan arriti një rezultat mëse të konsiderueshëm dhe u pozicionua në vendin e pestë (5) nga 35 kandidatët e Listës 7 të CVP-së (shih www.regierungsrat.bs.ch/staatskanzlei).

Informacione të tjera për personalitetin e saj mund të merren nga Homepage e CVP Baselstadtit: www.cvp.ch/kt/bs/deutsch/profiledetail.asp?id=1108 .

Si mundi në përgjithësi të vinte deri te kjo? Unë mendoj se ne muslimanët e bartim pjesën më të madhe të fajit për këto zhvillime negative, edhe atë, për veç të tjerash, për këto arsye:

1. Ne bëjmë shumë pak për t'iu kundërvënë frikës ndaj Islamit që dita-ditës bëhet gjithnjë e më e fuqishme,
2. Ne e lëmë pas dore sa s'bën punën e integritit,
3. Ne e lëshojmë rastin që vendosshmërisht dhe përpara të gjithë qytetarëve të Zvicrës zëshëm ta dënojmë terrorin, që ushtrohet nga kushdoqoftë në emër të Islamit.

Për mua, rruga e vetme e cila do ta ndalonte këtë zhvillim është që ne të mundohemi për një integrim aktiv. Kjo u takon para së gjithash vëllezërve e motrave që vijnë nga ndonjë vend e rreth tjetër kulturor. Fakti që njëri apo tjetra e kanë marrë nënshtetësinë dhe zotërojnë pasaportë zvicerane, nuk ndryshon asgjë në këtë drejtim. Mua më kujtohet një vëlla gjerman me prejardhje turke i cili në kufi ishte ankuar për kontrollin e rreptë. Atij i është thënë: “Pasaporta gjermane këndeje apo andej, Ahmeti mbetet Ahmet”.

Rasti është mëse i qartë, ne duhet të pranojmë se Ahmeti është gjithnjë Ahmet, por duhet të tregojmë se Ahmeti është një anëtar i vlefshëm i kësaj shoqërie dhe për qëllim ka mirëqenien e të gjithë qytetarëve. Kjo në ndërkohë është dhe detyrë jona që të angazhohemi për mirëqenien e të gjithë njerëzve. Ne nuk guxojmë që me veprimet tona të forcojmë bindjen se ne nga jashtë ndoshta dukemi të padëmshëm, por nga brenda bëjmë gjithçka që ta luftojmë shoqërinë e këtushme. Në vend të kësaj ne duhet që sa më shumë të inkuadrohemi e të veprojmë nëpër shoqata e organizata bëmirese, për të treguar se e kemi me gjithë mend. Përkundër shumicës së vendeve nga vijnë shumica e muslimanëve, Zvicra është një shoqëri qytetare në të cilën çdo individ e merr përgjegjësinë dhe është i vetëdijshëm që qytetari e bën shtetin dhe jo e kundërta. Shteti ka për detyrë t'i shërbejë qytetarit dhe jo qytetari shtetit siç është rasti në shumicën e vendeve nga vijnë ne. Pasi qytetarët e bëjnë shtetin, atëherë duhet që qytetarët t'u shërbejnë bashkëqytetarëve të tyre. Në vendet nga vijnë ne deri diku sundon një njëmendësi krejt tjetër. Në të vërtetë kjo këtu përputhet saktësisht me parimin islamik dhe neve nuk duhet të na vijë rëndë për ta dhënë kontributin tonë në këtë drejtim.

Na lejoni përfundimisht që të kërcejmë përtej hijes sonë dhe ta perceptojmë përgjegjësinë tonë ndaj nesh e ndaj të tjerëve! All-llahu xh. sh. na ndihmoftë!

Nga gjermanishtja:
Xhelal Qazimi